



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 3000/ Prot.

Tiranë, më 08 .11 .2023

**V E N D I M**

Nr 65 , datë 08 .11 .2023

**“PËR  
PROCEDURËN E ZGJEDHJES, EMËRIMIT DHE MËNYRËN E USHTRIMIT  
TË KOMPETENCAVE NGA ANA E ZËVENDËSINSPEKTORIT TË LARTË  
TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 204, pika 1, shkronja “g” dhe “k”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

**K O N S T A T O V A:**

Në zbatim të nenit 204, pika 1, shkronja “g”, dhe në zbatim të nenit 18, pika 3, të urdhrin nr. 119, datë 12.07.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, është thirrur dhe mbajtur Mbledhja e Përgjithshme e inspektorëve, me objekt shqyrtimin e propozimit të rregullave e të procedurës së zgjedhjes, emërimit dhe mënyrës së ushtrimit të kompetencave nga ana e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në përputhje me parashikimin e bërë në pikën 5, të nenit 205, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pasi inspektorët që ushtrojnë veprimtarinë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shqyrtuan dhe miratuan aktin e propozuar, si dhe në mbështetje të përmbledhjes së diskutimeve të mbajtura gjatë Mbledhjes së Përgjithshme të inspektorëve, të datës 01.11.2023, si pjesë e dokumentacionit shoqërues të këtij vendimi.

**V E N D O S A:**

1. Miratimin e procedurës së zgjedhjes, emërimit dhe mënyrës së ushtrimit të kompetencave nga ana e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për publikimin e këtij vendimi në faqen Zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORILLARTË IDREJTËSISË**

**Artur Metani**



**RREGULLA**  
**PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES, EMËRIMIT DHE MËNYRAT E**  
**USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE NGA ANA E ZËVENDËSINSPEKTORIT**  
**TË LARTË TË DREJTËSISË**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim përcakton rregulla të hollësishme lidhur me zhvillimin e procedurës së zgjedhjes, emërimit dhe ushtrimit të kompetencave nga ana e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Ky vendim ka për qëllim zhvillimin, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, transparencës barazisë dhe mosdiskriminimit, të procedurës për shqyrtimin e kandidaturave për zgjedhjen dhe emërimin, e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**II. PROCEDURA PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT DHE SHQYRTIMI I KËRKESAVE**

1. Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit të Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë, zhvillohet nëpërmjet njoftimit, paraqitjes së kërkesës për shprehje interesi, dhe verifikimit të plotësisë të kushteve ligjore nga inspektorët.
2. Procedura e paraqitjes së kërkesës, verifikimi i plotësisë të kushteve ligjore dhe renditja përfundimtare e inspektorëve, koordinohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili ndihmohet nga Sekretariati Teknik.
3. Sekretari i Përgjithshëm cakton rast pas rasti nëpunësit që do të shërbejnë si anëtarë të Sekretariatit Teknik dhe detyrat e tyre.
4. Njoftimi për shprehjen e interesit u përcillet elektronikisht të gjithë inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe qëndron i hapur për një periudhë prej 3 ditësh nga data e njoftimit. Inspektorët e interesuar depozitojnë kërkesat në rrugë elektronike në adresën e përcaktuar për këtë qëllim.
5. Për çdo inspektor të interesuar, Sekretariati Teknik brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të kërkesave përgatit relacionin, i cili u njoftohet secilit prej inspektorëve.
6. Brenda 3 ditëve nga dita e njoftimit të relacionit, inspektorët e interesuar kanë të drejtën e paraqitjes së ankimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.
7. Në përfundim të procesit të paraqitjes së shprehjeve të interesit, Sekretari i Përgjithshëm, paraqet relacionin me listën emërore të inspektorëve kandidatë që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 205, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 pranë

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

8. Lista përfundimtare e inspektorëve që kanë paraqitur kërkesë, u komunikohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektorëve për shqyrtim në Mbledhjen e Përgjithshme të inspektorëve.
9. Nëse inspektori i renditur i pari në listë, tërheq kërkesën përpara votimit, procedura vijon me inspektorin e renditur menjëherë pas tij.

### **III. PROCEDURA PËR ZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN E ZËVENDËSINSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

1. Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë përzgjidhet nga radhët e kandidatëve të cilët kanë shfaqur interes për kandidim dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj dhe emërohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pasi ka marrë mendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të inspektorëve midis inspektorëve.
2. Mbledhja e Përgjithshme e inspektorëve thirret dhe kryesohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm njoftimin për organizimin e Mbledhjes së Përgjithshme të inspektorëve si dhe nevojën për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për mbledhjen.
3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për:
  - a. administrimin e shprehjeve të interesit dhe mbledhjen e formularëve të plotësuar nga ana e inspektorëve, sipas shtojcës nr. 1, të këtij vendimi;
  - b. përgatitjen e relacionit përmbledhës, me listën emërore të inspektorëve kandidatë që plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 205, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar;
  - c. përgatitjen dhe shpërndarjen e fletës së votimit sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, pjesë përbërëse të këtij vendimi;
  - ç. regjistrimin audio të mbledhjes, transkriptimin dhe/ose zbardhjen e procesverbalit të Mbledhjes së Përgjithshme të inspektorëve.
4. Data, vendi dhe rendi i ditës i njoftohet të gjithë inspektorëve, të paktën 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes dhe shoqërohet me relacionin përkatës, ku pasqyrohen të dhëna në lidhje me inspektorët të cilët kanë shprehur interesin për të kandiduar si dhe plotësimin e kriterëve ligjore nga ana e tyre për pozicionin e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë.
5. Të gjithë inspektorët në detyrë janë anëtarë të Mbledhjes së Përgjithshme të Inspektorëve dhe janë të detyruar të votojnë. Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve është e vlefshme kur në të marrin pjesë, më shumë se gjysma e anëtarëve të mbledhjes dhe vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

6. Me kërkesë të secilit inspektor pjesëmarrës, diskutohet mbi kandidaturat për pozicionin e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në përfundim të diskutimeve, secili inspektor voton për kandidaturën përkatëse. Kandidati i cili ka marrë numrin më të lartë të votave shpallet nga Sekretariati Teknik si kandidati për të cilin Mbledhja e Përgjithshme e inspektorëve ka dhënë mendimin për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në rast të një rezultati të barabartë të kandidateve, përparësi ka inspektori me përvojën më të gjatë profesionale si inspektor.
7. Votimi është i fshehtë dhe individual. Kandidatët renditen në fletën e votimit sipas rendit alfabetik të emrit të tyre. Sekretariati Teknik shumëfishon një numër fletësh votimit të barabartë me numrin e inspektorëve të pranishëm në mbledhje.
8. Sekretariati Teknik kujdeset që të gjitha mendimet e dhëna nga anëtarët, si dhe mënyra e votimit për secilin kandidat, të regjistrohen në audio, transkriptohen, si dhe të bëjë pasqyrimin e tyre në procesverbalin e mbledhjes.
9. Sekretariati Teknik kryen numërimin e votave për secilin kandidat dhe liston sipas radhës duke vendosur të parin kandidatin me numrin më të lartë të votave, sipas shtojcës nr. 3, të këtij vendimi.
10. Inspektori i Lartë i Drejtësisë brenda 5 ditëve nga data e zhvillimit të mbledhjes, emëron Zëvendësinspektorin e Lartë të Drejtësisë. Mendimi i marrë nga Mbledhja e Përgjithshme e inspektorëve nuk është i detyrueshëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.
11. Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë, ushtron të gjitha kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 205, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 dhe nenet 13-16, të Rregullores së Brendshme të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratuar me urdhrin nr. 119, datë 12.07.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të ndryshuar. Në rast se Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë ka pengesë ligjore në ushtrimin e detyrave të tij, kur ndaj tij caktohet një masë disiplinore ose largohet nga puna si inspektor, ai zëvendësohet menjëherë, sipas kriterëve, procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë vendim

Shtojca nr. 1

## K Ë R K E S Ë

### “PËR SHPREHJE INTERESI PËR POZICIONIN E ZËVËNDËSINSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

**Drejtuar: Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me detyrë, inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në nenin 205, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar paraqes kandidaturën time, për t’u zgjedhur në detyrën e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptim,

Me konsideratë,

\_\_\_\_\_

Sot më datë DD.MM.VVVV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

FLETË – VOTIMI

“PËR  
PËRZGJEDHJEN E ZËVENDËSINSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Nr. rendor	Emri e Mbiemri i kandidatit	Shënimi i votës
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		
8.		
9.		
10		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

FLETA E RENDITJES, SIPAS REZULTATIT TË VOTIMIT PËR  
KANDIDATËT  
PËR  
POZICIONIN E ZËVËNDËSINSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Nr.	Emri, Mbiemri	Numri i votave
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		
8.		
9.		
10.		

SEKRETARIATI TEKNIK

\_\_\_\_\_  
(Emri, Mbiemri, anëtar)

\_\_\_\_\_  
(Emri, Mbiemri, anëtar)